



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 04 maj 2012
Nr. ref.: RK 229/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI27/11

Parashtruesi

Xhevdet Rrahmani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme
Rev. Nr. 820/2010, të 25 janarit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Xhevdet Rrahmani nga fshati Lladovc i Komunës së Podujevës.

Vendimi i kontestuar

2. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 820/2010, i 25 janarit 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon se i janë shkelur të drejtat e tij si person me aftësi të kufizuara. Parashtruesi nuk përmend në mënyrë specifike asnjë nen të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për të cilin thuhet se është shkelur. Parashtruesi kërkon njohjen e të drejtës së tij për të marrë pension si person me aftësi të kufizuara.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 28 shkurt 2011.
6. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), prof. dr. Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj.
7. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues më 7 mars 2012 dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

8. Më 5 shtator 1980, babait të parashtruesit i ishte njohur e drejta për shtesa për asistencë dhe kujdes për fëmijën me aftësi të kufizuara (për parashtruesin) nga BVI-ja republikane (Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit) për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Punëtorëve, Bashkësia për qytetin e Beogradit.
9. Më 27 janar 2006, parashtruesit iu miratua pensioni për persona me aftësi të kufizuara, u bë rektoaktiv që nga 12 janari 2005. Në atë kohë ishte konstatuar që parashtruesi i përmbushte kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë lidhur me përzgjedhshmërinë për pension të aftësisë së kufizuar dhe ishte njoftuar me anë të një shkrese se përzgjedhshmëria e tij do të shqyrtohej sërish brenda pesë vjetësh.
10. Më 20 prill 2010, përzgjedhshmëria e parashtruesit ishte rishqyrtuar nga Komisioni mjekësor për shqyrtime – Departamenti i Administratës Pensionale (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) dhe parashtruesit i ishte mohuar pensioni i aftësisë së kufizuar ngaqë konsiderohej se ai nuk kishte paaftësi të plotë dhe të përhershme.
11. Më 8 qershor 2010, parashtruesi ushtroi ankesë në Këshillin e ankesave për pensionet e personave me aftësi të kufizuar (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli).
12. Më 28 korrik 2010, ankesa e parashtruesit u refuzua si e pabazuar. Këshilli gjeti që vlerësimi i Komisionit se nuk kishte pasur prova të mjaftueshme për t'ia lejuar përzgjedhshmërinë për përfitime nga pensioni për paaftësi të plotë dhe të përhershme

ishite i drejtë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuara

13. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Supreme kundër vendimit të Këshillit. Në këtë ankesë, parashtruesi e kontestonte ligjshmërinë e vendimit të Komisionit dhe pretendoi se Komisioni nuk i kishte marrë parasysh provat që ai i kishte paraqitur lidhur me gjendjes e tij të rëndë mjekësore dhe paaftësinë e tij për punë.
14. Më 25 janar 2011, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin A. nr. 820/2010, e refuzoi ankesën si të pabazuar. Gjykata Supreme gjeti që komisioni e kishte zbatuar drejt Ligjin Nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë pasi kishte konstatuar se parashtruesi nuk i përmbushte kriteret e nenit 3 të atij Ligji.
15. Ky vendim iu dorëzua parashtruesit më 15 shkurt 2011.

Pala që bart barrën e të provuarit të fakteve

16. Në përputhje me rregullin 29.2 (h) të Rregullores së punës, është detyrë e parashtruesit që kërkesës t'ia bashkëngjisë "informacionet dhe dokumentacionin mbështetës".

Argumentet ligjore të paraqitura nga parashtruesi

17. Parashtruesi pohon që gjetjet e Gjykatës Supreme, të Këshillit dhe të Komisionit ia shkelin të drejtat e tij si person me aftësi të kufizuara. Në veçanti, parashtruesi duket të argumentojë se Komisioni dështoi t'i merrte parasysh provat e paraqitura nga parashtruesi kur erdhi në përfundim se ai nuk ishte i përzgjedhshëm për pension për aftësi të kufizuara. Parashtruesi nuk ka specifikuar cili nen i Kushtetutës së Republikës së Kosovës është shkelur, por mund të konkludohet se ai beson që është shkelur neni 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale].

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregullore të punës.

19. Neni 113, paragrafët 1 dhe 7, i Kushtetutës përcakton kornizën e përgjithshme ligjore që kërkohet për pranueshmëri. Ai përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

20. Përveç kësaj, neni 48 i Ligjit thotë:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

21. Së fundi, rregulli 36 i Rregullores së punës thotë:

“1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) kërkesa është qartazi e bazuar.

2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të së drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

22. Parashtruesi duket të pohojë, por nuk e cek në mënyrë specifike në kërkesën e tij, që është shkelur neni 51 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Neni 51 thotë:

“1. Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.

2. Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj.”

23. Dispozita përkatëse e Ligjit në fjalë, neni 3 i Ligjit Nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, përcakton kriteret për përcaktimin e aftësisë së kufizuar:

“3.1 Për të fituar të drejtën në pension të aftësisë së kufizuar, parashtruesi i kërkesës duhet të ketë banim të përhershëm në Kosovë dhe t'i përmbushë kërkesat, sipas këtij ligji, që duhet përmbushur për pension të aftësisë së kufizuar.

3.2 Komisionet mjekësore do të vlerësojnë gjendjen shëndetësore të parashtruesve të kërkesave për pensionet e aftësisë së kufizuar. Vlerësimet e aftësisë së kufizuar nga ana e komisioneve mjekësore duhet të jenë me shkrim dhe duhet të përfshijnë me sa vijon:

a) Deklaratën e posaçme të diagnozës për gjendjen faktike, ndijore apo mendore, sëmundjen apo aftësinë e kufizuar prej të cilës parashtruesi i kërkesës vuan dhe datën e paraqitjes së gjendjes, sëmundjes apo aftësisë së kufizuar; diagnoza duhet të përshkruajë gjendjen shëndetësore, sëmundjen ose aftësinë e kufizuar si dhe ndikimin e posaçëm të gjendjes shëndetësore, sëmundjes apo aftësisë së kufizuar në punësim, duke përfshirë përshkrimin e thukët të funksionimit të dobësuar të parashtruesit të kërkesës.

b) Vlerësimin e funksionimit të parashtruesit të kërkesës për sa i përket detyrave të përditshme dhe atyre lidhur me punësim; ky duhet të përfshijë referencën e punësimit të mëparshëm të parashtruesit të kërkesës, nëse ka qenë i punësuar.

- c) Përcaktimi se a mund apo nuk mund të punësohet parashtruesi i kërkesës, në çfarëdo cilësie, duke i pasur parasysh rrethanat e përgjithshme të sëmundjes ose aftësisë së kufizuar.
- d) Përcaktimi i aftësisë së plotë të kufizuar për një periudhë prej një viti apo më gjatë, gjatë secilës kohë parashtruesi i kërkesës ka qenë i paaftë për punësim të shpërblyeshëm.
- e) Prognozimi i aftësisë së kufizuar të përhershme.

3.3 Personat që banojnë ose janë mbyllur në institucione të tipit të mbyllur ose që marrin ndihmë të rregullt dhe të vazhdueshme financiare nga institucionet që përkujdesen për personat me aftësi të kufizuar, duke i përfshirë institucionet psikiatrike, institucionet religjioze që përkujdesen për të sëmurit ose njerëzit me aftësi të kufizuar, shkollat rezidenciale, burgjet dhe institucionet e tjera që mbështeten nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për t'u përkujdesur për njerëzit me aftësi të kufizuar, nuk do të jenë të përzgjedhshëm për pensionin e aftësisë së kufizuar, sipas këtij ligji.

3.4 Personat të aftë për punësim apo që aktualisht janë të punësuar në çfarëdo mënyre duke përfshirë çfarëdo lloji vetëpunësimi, siç përkufizohet në ligjet tatimore të Kosovës, nuk do të jenë të përzgjedhshëm për pensionin e aftësisë së kufizuar. Përzgjedhshmëria për pensionin e aftësisë së kufizuar do të pushojë në ditën e parë të punësimit ose vetëpunësimit...”

24. Neni 4.6 i Ligjit Nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, u referohet dëshmime në të cilat Komisioni mund ta bazojë vendimin e vet, duke përcaktuar:

“Komisioni mjekësor mund ta mbështesë vendimin e vet në bazë të dëshmime të parashtruesit të kërkesës për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të aftësisë së kufizuar të përhershme dhe/ose në bazë të ekzaminimeve dhe të gjeturave të tyre mjekësore. Të gjithë parashtruesit e kërkesave duhet t'u nënshtrohen ekzaminimeve mjekësore që bëhen nga komisioni mjekësor. Komisioni mjekësor nuk është i obliguar që ta pranohet dëshminë mjekësore të cilën e paraqet parashtruesi i kërkesës por mund ta marrë atë parasysh në përcaktimin e tij.”

25. Parashtruesi nuk paraqet prova në kërkesën tij se Ligji Nr. 2003/23 ishte shkelur, duke rezultuar kështu në shkelje të nenit 51 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në të vërtetë, ligji posaçërisht thekson se Komisioni nuk duhet të mbështetet në provat e ofruara nga parashtruesi i kërkesës në përcaktimin e tij.

26. Siç është thënë nga Gjykata Kushtetuese në Rastin Nr. KI. 06/09, Parashtruesi X kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Nr. 215/2006; Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Nr. 741/2005; Aktgjykimit të Gjykatës Komunale Nr. 217/2004:

“...Gjykata dëshiron të theksojë se nuk është gjykatë e apelit për gjykatat e tjera në Kosovë dhe se nuk mund të ndërhyjë mbi bazën se gjykatat e tilla kanë marrë vendim të gabuar ose kanë bërë vlerësim të gabuar të fakteve. Roli i Gjykatës është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si gjykatë “e shkallës së katërt”, (shih, mutatis mutandis, ndër të tjera, Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65).

27. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në përputhje me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, i cili thotë: “Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

PËR KËTO ARSYE

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 7 mars 2012, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'i komunikohet parashtruesit; dhe
- III. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani